VENDIM
Nr. 527, datë 1.8.2024

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 63, DATË 7.2.2024, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË PRANIMIT TË DREJTPËRDREJTË NË TND EDHE PËR KANDIDATË TË TJERË JASHTË SHËRBIMIT CIVIL DHE PËR PËRDORIMIN E PROCEDURËS SË PRANIMIT TË DREJTPËRDREJTË NË TND, PËR VITIN 2024"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 27, pika 5, e 29, pika 1, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar; si dhe në vijim të pikave 2, 3 e 4, të kreut V, të vendimit nr. 118, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3, të vendimit nr. 63, datë 7.2.2024, të Këshillit të Ministrave, fjalët "... është 6 (gjashtë)." zëvendësohen me "... është 10 (dhjetë).".

2. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama